

# 10 FAKTE QË DUHET T'I DINI RRETH PROGRAMIT TË TALLONËVE USHQIMORË

- Fakt:** Programi i Tallonëve Ushqimorë nuk është një program i ndihmës sociale. Është një programi i asistencës së të ushqyerit që synon të ndihmojë individët dhe familjet me të ardhura të ulta për të blerë dhe konsumuar ushqime me vlera ushqyese.
- Fakt:** Programi i Tallonëve Ushqimorë është një program që i garanton dhe i siguron përfitimet. Me fjalë të tjera, çdo njeri që aplikon dhe që për të cilin merret vendimi se është i pranueshëm, do t'i marrë përfitimet e tallonëve ushqimorë.
- Fakt:** Tallonët ushqimorë janë për individë dhe familje që i plotësojnë kërkesat, duke përfshirë të moshuarit, të paaftët, familjet që punojnë, disa kategori të caktuara imigrantësh ligjorë dhe fëmijët e tyre të lindur në SHBA.
- Fakt:** Individët mund të zotërojnë ose të blejnë një shtëpi dhe përsëri mund të marrin tallonë ushqimorë. Shtëpia dhe toka e saj nuk llogariten si pasuri në Programin e Tallonëve Ushqimorë. Programi i Tallonëve Ushqimorë nuk kërkon që njerëzit të ndryshojnë pronësinë e shtëpisë së tyre.
- Fakt:** Në vitin 2000, të moshuarit që jetonin vetëm, merrnin mesatarisht 43 dollarë në muaj; ndërsa të moshuarit që nuk jetonin vetëm, merrnin një përfitim mesatar prej 118 dollarësh në muaj.
- Fakt:** Nëse një person i moshuar ose i paaftë nuk është në gjendje të shkojë në zyrën e tallonëve ushqimorë, ai ose ajo mund të kërkojë një intervistë telefonike. Personi gjithashtu mund t'i kërkojë një të afërmi, prifti, fqinji etj, të jetë i pranishëm në intervistë si një përfaqësues i autorizuar. Aplikuesit dhe marrësit e SSI nuk duhet të aplikojnë për përfitime të tallonëve ushqimorë në Zyrën e Sigurimeve Shoqërore.

**Fakt:** Shpenzimet mjekësore më të larta se 35 dollarë në muaj mund të zbriten nga të ardhurat totale të familjes, përveçse rastit kur ndonjë kompani sigurimesh ose dikush që nuk është pjestar i familjes paguan për to. Shuma mbi 35 dollarë mund të zbritet.

**Fakt:** Caku i pasurisë për familjet e moshuara ose familjet që kanë një person të moshuar është deri në 3000 dollarë. Caku i pasurisë për të gjitha familjet e tjera është deri në 2000 dollarë.

**Fakt:** Familjet mund të marrin tallonë ushqimorë dhe përsëri mund të marrin Meals-on-Wheels (program i siguruar nga një organizatë vullnetare grash, përmes së cilës u çohen të moshuarve, të paaftëve ushqime me makinë), përfitime nga Programi i të Ushqyerit Suplementar Special për Gra, Foshnje dhe Fëmijë (Special Supplemental Nutrition Program for Women, Infants, and Children - WIC) dhe përfitime të të Ushqyerit të Fëmijës, të tilla si Programi i Drekës në Shkollë.

**Fakt:** Marrja e përfitimeve nëpërmjet Programit të Tallonëve Ushqimorë nuk do ta bëjë familjen e përbërë prej imigrantëve ligjorë një barrë publike.

Në përputhje me ligjin Federal dhe politikën e Departamentit të Bujqësisë së Shteteve të Bashkuara, ky institucion e ka të ndaluar të diskriminojë në bazë të racës, ngjyrës, origjinës kombëtare, seksit, moshës, besimit fetar, bindjeve politike ose paaftësisë.

Për të bërë një ankesë diskriminimi, shkruani tek: USDA, Director, Office of Civil Rights, Room 326-W, Whitten Building, 1400 Independence Avenue, SW, Washington, D. C. 20250-9410 ose telefononi (202)720-5964 (me zë dhe pajisje telekomunikimi për të shurdhët).

Personat me paaftësi që kanë nevojë për mënyra alternative komunikimi të informacionit të programit (alfabetin Brail, shkronja të mëdha, kaseta, etj) duhet të kontaktojnë qendrën TARGET të USDA në numrin (202) 720-2600 (me zë dhe pajisje telekomunikimi për të shurdhët).

### *Tallonët ushqimorë e bëjnë Amerikën më të fortë*

*USDA është një sigures dhe punëdhënës i shanseve të barabarta.*